



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

---

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

**DPL.nr.03/2023**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi, kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. \_\_\_\_\_ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës ( tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbarimore në çështjen përmbarimore P. nr 153/14, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - \_\_\_\_\_, udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira , në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore dhe përmbaruesit privat, z. \_\_\_\_\_ dhe pas seancës këshillimore, me datën 26.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira DPL nr.03/2023, datë 25.01.2023, si i pa bazuar.

**A R S Y E T I M**

Me datën 25.01.2023, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, ndaj përmbaruesit privat z. \_\_\_\_\_ ka inicuar procedurën disiplinore, me pretendimin se përmes zyrës së Prokurorisë Themelore në \_\_\_\_\_ Ministria e Drejtësisë është njoftuar se me datën 22.06.2018 është dorëzuar kallëzim penal ndaj Përmbaruesit Privat për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar; Prokurori i rastit me datën 16.12.2021 ka ngritur aktakuzë ndaj Përmbaruesit Privat në drejtim të veprës penale” Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Pala inicuese në përputhje me nenin 366 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore si dhe nenin 3, paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MD-nr.09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbaruesve Privat, si dhe në bazë të asaj që përcaktohet në Udhëzimin Administrativ MD-nr.09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj përmbaruesit privat, respektivisht në nenin 10 janë paraparë veprimet e Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat në rastet urgjente, ku më

konkretisht në paragrafin 1 dhe 2 përcaktohet që: “Raste urgjente konsiderohen kur...ndaj përmbauesit privat është ngritë aktakuzë...Në raste urgjente të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe me qëllim të ruajtjes së besimit të publikut në sistemin e përmbaimit privat, Komisioni vepron me urgjencë dhe çështjen disiplinore e përfundon në tërësi brenda 24 orëve”. E propozon iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor duke e trajtuar me urgjencë këtë rast dhe të njëjtin ta përfundoj brenda 24 orëve.

Komisioni Disiplinor ka caktuar seancën menjëherë për datën 26.01.2023.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë- Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, në seancë ka deklaruar se mbetet në tërësi si në propozimin e iniciimit të procedurës disiplinore dhe deklaroi se nuk ka prova të tjera shtesë përpos atyre që janë dorëzuar në rastin e iniciimit të procedurës.

Përmbauesi Privat në seancë më tutje ka deklaruar se bëhet fjalë për lëndën me shenjen E-2674/12 e datës 27.12.2012, me shenjen të përmbauesi privat P.nr.153/14 me kreditor \_\_\_\_\_ nga të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_ avokat nga \_\_\_\_\_ me debitor \_\_\_\_\_ me seli ne \_\_\_\_\_ Fillimisht është bërë bllokimi i llogarive i datës 10.02.2016 në të gjitha bankat komerciale të cilat kanë operuar në atë kohë në Kosovë.

Të autorizuarit e kreditorit me datën 24.02.2016 i është bërë pagesa në vlerë prej 1,378.09 euro, një pagesë tjetër në vlerë prej 158.00 euro, pagesa e datës 20.02.2017 në vlerë prej 499.00 euro. Me datën 29.02.2018 kreditori dhe debitori kanë arritë marrëveshje për pagesën e mbetur të borxhit dhe janë marrë vesh që debitori ta paguaj shumën prej 2,600.00 euro dhe lënda mbyllet në tërësi. I autorizuarit i kreditorit fillimisht në vitin 2018 ka ushtruar propozimin për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Departamentit për Profesione të Lira të Ministrisë së Drejtësisë, i pa kënaqur me vendimin e Departamentit për Profesione të Lira i cili ka konstatuar se nuk ka shkelje dhe lënda nuk mund ti referohet Komisionit Disiplinor, i autorizuarit i kreditorit ka ushtruar kallëzim penal ndaj përmbauesit, dhe ndaj zyrtarëve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_

Prokurorja e rastit nuk e ka filluar ndjekjen ndaj të punësuarëve në Departamentin për Profesione të Lira dhe ka ngritur aktakuzë ndaj përmbauesit me pretendimin se i njëjti ka bërë shkelje zyrtare duke e dëmtuar palën në vlerë prej 208.93 euro. Meqenëse në këtë lëndë të autorizuarit të kreditorit i është bartur shuma prej 2,035.09 euro dhe palët kanë arritur marrëveshje që të paguhet borxhi i mbetur për shpenzime të përmbaimit në lartësi prej 2,600 euro, vlera e përmbauesit mbi bazën e së cilës llogaritet tarifa e efikasitetit në këtë rast, është shuma prej 4,635.09 euro e shumëzuar me 10% dhe jepet shuma 463.50 euro plus TVSh-ia, e që na jep shumën prej 546.93 euro. Pasqyrën e shpenzimeve, përmbauesi ia ka dërguar të autorizuarit të kreditorit. Meqenëse eksperti i angazhuar nga Prokuroria vlerën e efikasitetit e ka llogaritur mbi bazën e shumës 2,600 euro e që është dashur të bëhet kalkulimi me ekspertizë për tarifë të efikasitetit në shumën prej 4,635.09 euro, atëherë ekspertiza e nxjerrë në procedurë penale e datës 10.01.2023 e punuar nga eksperti financiar \_\_\_\_\_ rezulton se ky përmbaues privat ka vepruar konform Udhëzimit Administrativ për tarifa.

Përmbauesi privat po ashtu ka potencuar se veprimi i tij i fundit si përmbaues privat në çështjen përmbaimore është marrë më datën 30.01.2018 kur është mbyllur lënda. Ka kërkuar që Komisioni ta këtë parasysh që veprimet e fundit janë ndërmarrë me datën 30.01.2018 dhe Komisioni duhet ta

trajtoj si veprim të parashkruar duke marrë parasysh datën e veprimit të fundit të ndërmarrë dhe datën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor, me kujdes, vëmendje të veçantë ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku.

Komisioni disiplinor gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej 6 muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një vit nga dita e shkeljes.

Komisioni gjen se veprimet e fundit përmbarimore në këtë rast janë ndërmarrë me datën 30.01.2018, ndërsa procedura disiplinore është iniciuar me datën 25.01.2023 pasi që pala inicuese ka rënë në dijeni se për këtë rast është ngritur aktakuzë ndaj përmbaruesit privat.

Komisioni e ka trajtuar këtë rast me karakter urgjent duke caktuar seancën brenda 24 orëve për shkak të ngritjes së aktakuzës ndaj përmbaruesit privat, ndërsa sa i përket shkeljeve eventuale të bëra nga përmbaruesi privat nuk është lëshuar fare për shkak të kalimit të afatit ligjor për shqyrtimin e atyre shkeljeve.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 03/2023, datë 26.01.2023**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**  
**Manushe Karaçi**



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.